



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.218/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj – kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Kosovski Savez në Komunën e Klllokotit, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR ankesa ZL.Anr.218/2025, e datës 14.10.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Kosovski Savez në Komunën e Klllokotit, e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 14.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.218/2025, paraqitur nga Subjekti Politik Kosovski Savez në Komunën e Klllokotit, për shkak të parregullsive serioze të vërejtura gjatë procesit zgjedhor më 12.10.2025 në vendvotimet e komunës së Klllokotit, në lokalitetet Mogillë, shkolla "Marko Rajković" dhe fshati Vërboc, shkolla fillore "Marko Rajković". Konkretisht, u konstatua se një numër i madh i votuesve morën dëshmi mjekësore, afërsisht 20 (siç u vërtetua edhe nga policia në vend), pas së cilës u privua mjekja në stacionin e policisë në Klllokot, ku u thirr edhe prokurori i shtetit. Për të gjitha informacionet shtesë, mund të kontaktoni stacionin e policisë në Klllokot dhe prokurorin e detyrës. Po ashtu, posedojnë dëshminë personale të Slobodan Jovanoviqit, të cilit Ognjen Krçmareviq i dha një dëshmi mjekësore nga xhepi i tij gjyshit të Slobodan Jovanoviqit nga Gërçari. Me që ra fjala, Ognjen Krçmareviq është anëtar i KKZ-së së Klllokotit. Më tej në ankesë theksohet se përveç kësaj parregullsie të rëndë që ndodhi në vendvotimet, kandidati për kryetar të Listës Serbe, anëtarët e familjes së tij, anëtarët e Listës Serbe, bllokuan rrugën në të dy drejtimet drejt vendvotimeve dhe ndalnin dhe i shantazhonin votuesit. Kërkojnë anulimin e Zgjedhjeve lokale në Komunën e Klllokotit.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Srpska Lista, thekson se kjo ankesë është paradoksale, e pambeshtetur dhe absolutisht e pabazuar nga ana juridike. Para së gjithash, si subjekt legal politik në Kosovë, ne nuk kemi kompetencë mbi institucionet shëndetësore, qofshin ato që funksionojnë sipas sistemit serb apo kosovar. Duke u nisur nga ky fakt, nuk

shohim si të kuptimtë që ankesa të referohet subjektit tonë politik. Po ashtu, ne as nuk e dimë e as nuk mund ta dimë se nga erdhi kjo dëshmi, si dhe pse u lëshua, dhe ajo që është më e rëndësishmja, ne nuk mund të jemi përgjegjës për veprimet e ndonjë personi tjetër juridik apo fizik. Më tej në përgjigje theksohet se Goran Marinković pa përcaktueshmëri thotë se 20 persona sipas vlerësimit të tij votuan me ndihmën e asistentit, pa i përmendur emrat e personave, numrin e tyre, vendin ku votuan, as lidhjen midis personit/personave të përmendur me subjektin politik Lista Serbe. Shtrohet pyetja se si e di z. Marinković se ata persona janë votues ose anëtarë të Listës Serbe dhe ku është aty përgjegjësia e subjektit politik në fjalë nëse disa votues votuan me ndihmën e asistentit personal. Në këto zgjedhje lokale, Goran Marinković fitoi 73 vota, që është rreth 3% e votave, prandaj është e qartë se ai nuk është i kënaqur me rezultatin e arritur dhe tani përpiket të shpërdorojë të drejtën e ankimit për të njoollur emrin e subjektit tonë politik dhe të vërë në dyshim procesin zgjedhor i cili ka ecur në një atmosferë të nderhme dhe demokratike. Gjithashtu, përveç deklaratës së tij, nuk ka asnjë provë që ngjarja e përmendur ka ndodhur, as që ai vetë ka paraqitur ndonjë provë.

E drejta që personat të përdorin asistencë është e rregulluar me akte juridike. Në vendvotimin, vendimin për të mundësuar votimin me ndihmën e asistentit e marrin anëtarët e komisioneve zgjedhore, dhe në këtë kuptim Lista Serbe nuk mund të ketë ndikuar në faktin nëse do të mundësohej apo jo votimi me ndihmën e asistentit, prandaj vetëm nga kjo nuk mund të mbajë përgjegjësi për këtë ngjarje të pretenduar. Si dhe pretendimet se kandidati për kryetar komune nga Lista serbe, me anëtarët e familjes së tij dhe anëtarë të Listës Serbe, kanë bllokuar rrugën në këtë komunë. Ne me përgjegjësi pohojnë se një ngjarje e tillë nuk ka ndodhur, as që diçka e tillë ishte e mundur, dhe pohimet tyre mund t'i konfirmojnë anëtarët e policisë së Kosovës dhe EULEX që e monitoruan të gjithë procesin zgjedhor gjatë gjithë ditës.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), të datës 14.10.2025, sqaron bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024 - Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, përcaktohet procedura e detajuar për realizimin e votimit me asistencë.

KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 15.10.2025 ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Klllokotit, nga e cila ka marrë përgjigjen dhe konfirmimin si më poshtë: KKZ në Klllokot ka deklaruar se "Unë për atë rast jam vënë në dijeni vetëm pasi erdhën nga Prokuroria. Pas bisedës dhe pasi mësova se rasti i përmendur kishte ndodhur, menjëherë dërgova anëtarët e KKZ-së për të vizituar Vendvotimin dhe për të parë në vendin ngjarjes se gfarë kishte ndodhur në të vërtetë, ata kanë kuptuar që një rast ka ndodhur dhe anëtarët kane reaguar dhe menjëherë e kane ndërprerë votimin e mëtutjeshëm me këtë Gjithashtu, ju njoftojmë se për këtë rast KKZ-ja e Komunës së Klllokotit ka raportuar në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025, duke deklaruar si në vijim"

"Anëtari i KQZ në komunën e Klllokotit ka njoftuar se një doktoresh në Klllokot është duke lëshuar vendime për aftësi mjekësore me qëllim që këta votues të votojnë me asistencë Doktoresha është duke lëshuar vendimet me datë 12.10.2025", Në përgjigje ka bashkangjitur Raportin e Dhomës operative për ditën e zgjedhjeve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive gjatë numërimit të votave, nuk hynë në kompetencë të PZAP për të vlerësuar apo verifikuar vërtetësinë e dokumentacionit mjekësor që ka poseduar Ognjen Krçmareviq. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor me të cilin atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor - faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“në rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesave të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.218/2025 më datën 15.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.